KËRKESË
Nr. 488/5, datë 23.6.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për disa shtesa dhe ndryshime të VKM-së nr. 231, datë 17.4.2019, të ndryshuar, "Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor 'Mbikalimi i Pallatit me Shigjeta–rrethrrotullimi 'Shqiponja"".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për interes publik për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit në ARRSH, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 16,127,735.4 (gjashtëmbëdhjetë milionë e njëqind e njëzet e shtatë mijë e shtatëqind e tridhjetë e pesë pikë katër) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË
POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni

LISTA EMËRORE E PRONARIT PASURIA E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, E TË CILIT PREKET NGA DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 231, DATË 17.4.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR 'MBIKALIMI I PALLATIT ME SHIGJETA–RRETHRROTULLIMI 'SHQIPONJA""

| 5 | Të dhënat sipas VKM-së nr. 463, datë 10.6.2020 | | | | | | | | | | | | | | | | | | Të dhënat pas ndryshimit | | | | | | | | | | | | | | | | | |